22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë

që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shumat absolute të të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare

- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Date _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

1. **Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve me kodin 18.01.01,18.01.03 dhe 18 01 08** duhet të realizohet nga impiante të miratuara nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit (ish Ministria e Mjedisit) për kryerjen e këtij shërbimi.
2. Mbetjet do të merren nga sipërmarrësi pranë ambjentit të shërbimit që do të vendoset nga Autoriteti Kontraktor / QSUNT, me automjetet të posaçëm në pronësi/qira të Kontraktuesit, lehtësisht të identifikueshëm gjatë transportit të mbetjeve me shenjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjeve të rrezikshme spitalore në përputhje me pikat 8.8/c dhe shtojcën nr.4 të VKM-së Nr.798 dt.29.09.2010 dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhezuesin Kombëtar "Administrimi i sigurtë i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore".
3. Tërheqja e mbetjeve do të bëhet sipas nevojave dhe kërkesës së AK -së.
4. Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, apo nëpërmjet cdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, minimalisht 5 automjete llojit furgon, që nuk e kalojnë peshën totale me gjithë ngarkesë 3500 kg, pasi këto lloj automjete janë të manovrueshëm për të qarkulluar në ambientet spitalore.
5. Operatori ekonomik do të kryejë furnizimin me kontenier dhe qeset përkatëse të ambalazhimit sa herë që tërheq sasitë e gjeneruara të mbetjeve dhe sa herë kërkohet nga Autoritetit Kontraktor. Materialet e furnizuara nga kontraktori duhet të jenë si më poshtë:
 - 5.1 Kontenierët plastikë ose kuti kartoni me qese plastmase duhet të jenë sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr.798 datë 29.09.2010 “Për Administrimin e mbetjeve spitalore” Pika 8/4 dhe 8/5 të Kreut III, Trajtimi i mbetjeve spitalore.
 - 5.1.1 Kutit plastikë njëpërdorimësh për të mprehtat (18 01 01), përmasa që fillon nga 3L, me ngjyrë të verdhë apo kombinim i të bardhës dhe të verdhës (në do vijohet me evadimin e këtyre mbetjeve).
 - 5.1.2 Kutit plastike të ripërdorshme me përmasa nga 30-60 L, për mbetjet infektive 18 01 03, të cilët për cdo përdorim duhet ti nënshtrohen pastrimit dhe larjes në makinerinë e posaçme të operatorit si dhe qese plastmase të verdhë.
 - 5.1.3 Kutit të posaçme farmaceutike/kontainerë të posaçëm ngjyrë e kuqe për mbetjet me kodin 18 01 08.
6. Operatori Ekonomik nuk duhet të veprojë asnjëherë pa praninë e përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor. Për kryerjen e shërbimeve operatori ekonomik duhet të paraqesë situacionin përmbledhës, dokumentat dhe faturat shoqëruese për sa është realizuar, proces-verbalin për shërbimin e kryer të firmosur mes dy palëve (të operatorit ekonomik dhe përfaqësuesit të sektorit që monitoron kontratën), dokumentacion për depozitim të hirit, depozitim të mbetjeve të trajtuara, printime të impiantit të trajtimit dhe informacion mbi realizimin e asgjësimit/sterilizimit të mbetjeve .

7. Operatori Ekonomik do të vejë në dispozicion peshore elektronike dore, me kapacitet maksimal mbajtës deri në 20 kg, për të pajisur pavionet e QSUNT si dhe peshore për çdo PAI, me kapacitet nga 100 kg deri në 150 kg. Peshoret për PAI-t me kapacitet nga 100 deri 150kg duhet të jenë të kolauduar nga Drejtoria e Metrologjisë.

Konkretisht duhet të vërë në dispozicion peshore si më poshtë:

7.11 Peshore elektronike dore me kapacitet deri në 20 kg (70 copë).

7.12 Peshore me kapaciteti nga 100 deri në 150 kg (7 copë).

Shënim: Peshoret me kapacitet nga 100 kg deri në 150 kg për PAI-t, duhet të jenë të certifikuar CE dhe të kolauduara.

8. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve të grumbulluara, Operatori Ekonomik do të realizojë dezinfektimin e ambientit të grumbullimit të mbetjeve pranë AK, pas çdo evadimi mbetjesh.

9. Personeli i përfshirë në ngarkimin e koshave/ kontejnerëve tranzit duhet të jetë kompetent dhe i trajnuar siç duhet, detyrim që buron nga pika 9.3.2 e Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurtë të Mbetjeve. Sigurimi i jetës dhe shëndetit në punë të personelit është përgjegjësi e Kontraktorit.

10. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik tek një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike sipas shtojcës 1 të VKM-së Nr.371, datë 11.06.2014 për “Përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, i ndryshuar.

11. Për garantimin e standardeve të menaxhimit të cilësisë, mbi objektin e shërbimit, standardet mjedisore si dhe shëndetin dhe sigurinë në punë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë të gjitha Certifikatat si më poshtë :

11.11 ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent

11.12 ISO 14001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit) ose ekuivalent

11.13 ISO 45001:2018 (Mbi sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë) ose ekuivalent;

Shënim: Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga RSH dhe brenda afatit të vlefshmërisë.

12. OE duhet të disponojë Akt-Miratim Higjeno-Sanitar të impiantit ky kryhet aktiviteti të lëshuar nga ISHS, detyrim që buron nga pika 10.3, kreu IV, VKM Nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore".

13. **Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve me kodin 18.01.01, 18.01.03 dhe 18 01 08** duhet të realizohet me një prej metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara në VKM nr 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, konkretisht:

- 13.11 **Mbetjet me kodin 18 01 01** “*Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)*” do të asgjësohen me sterilizim.
- 13.12 **Mbetjet me kodin 18.01.03** “*Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet*” do të asgjësohen me sterilizim ose incenerim
- 13.13 **Mbetjet me kodin 18 01 08*** Medikamente citostatike dhe citotoksike” do të asgjësohen me incenerim.

14. Operatori Ekonomik duhet të disponojë **Leje Mjedisore tipi A** (me kod III.1.C) **dhe B me** (kod III.1.B) **ose Leje Mjedisore tipi A** (me kod III.1.C) lëshuar nga Ministria e Mjedisit, së bashku me Akt Miratimin përkatës për asgjësimin e mbetjeve, ku të përfshij kodet e mbetjeve si më poshtë:

18 01 01 “*Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)*”

18 01 03 “*Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet*”

18 01 08 “*Medikamente citostatike dhe citotoksike*”

Licensën përkatëse të kategorisë **III.2.B.**

15. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, apo nëpërmjet cdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, implant/e, makineritë e mëposhtme që të mbulojë trajtimin e mbetjeve 18 01 01, 18 01 03, 18 01 08 sipas Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”i ndryshuar si dhe të VKM-së për miratimin e rregullores “Për menaxhimin e mbetjeve spitalore” si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- 15.11 Implant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalent) ose Implant për asgjësimin me incenerim si dhe ;
- 15.12 Implant për asgjësimin me incenerim si dhe ;
- 15.13 Makineri për larjen e kontenierëve (në rastet kur përdoren kontenier të ripërdorshëm)

16. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësim/trajtim, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që **del nga procesi i trajtimin me teknologjinë** inceneratorët ose piroliza e mbetjeve me kodin 19 01 ose produktin final që del nga procesi i trajtimin me teknologji me sterilizim, pra mbetje të stabilizuara të ngurtësuarame kodin 19 03.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore të rrezikshme për 24 muaj (kodet 18.01.01, 18.01.03, 18.01.08)”.

Afatet e ekzekutimit:

Nr.	“Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore të rrezikshme për 24 muaj (kodet 18.01.01, 18.01.03, 18.01.08)”	Vendi i ekzekutimit	Sasia e parashikuar per 24 muaj
1	<i>Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.01</i>	QSU “Nënë Tereza”	220,712
2	<i>Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.03</i>	QSU “Nënë Tereza”	238,514
3	<i>Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.08</i>	QSU “Nënë Tereza”	6,168

Sasia për nevojat e AK për 24 muaj parashikohet në: 465,394 kg.

Shtojca 8.

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: ***“Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore të rrezikshme për 24 muaj (kodi 18 01 01, 18 01 03, 18 01 08)”***, për realizimin e nevojave të Autoritetit Kontraktor QSUNT, si qendër spitalore terciare, e vetme në Republikën e Shqipërisë.

Detyrat: Specifikimet teknike për procedurën e prokurimit me objekt: ***“Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore të rrezikshme për 24 muaj (kodi 18 01 01, 18 01 03, 18 01 08)”***, janë bazuar në:

- Ligjin Nr.10463 datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”;
- Udhëzuesin Kombëtar të Administrimit të Sigurtë të Mbetjeve Spitalore;
- VKM Nr.798 datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”;
- Ligjin Nr.8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- VKM Nr.99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” i ndryshuar me VKM Nr.402 datë 30.06.2021;
- Ligjin 10448, datë 14.07.2011 për Lejet e Mjedisit i ndryshuar;
- Rregulloren e Brendshme të Administrimit të Mbetjeve Spitalore të miratuar, me Nr.Prot.3501/6 datë 25.09.2018;
- VKM Nr.371, datë 11.06.2014 për “Përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, i ndryshuar;
- Protokoll për kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor.

1. ***Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve me kodin 18.01.01,18.01.03 dhe 18 01 08*** duhet të realizohet nga impiante të miratuara nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit (ish Ministria e Mjedisit) për kryerjen e këtij shërbimi.
2. Mbetjet do të merren nga sipërmarrësi pranë ambjentit të shërbimit që do të vendoset nga Autoriteti Kontraktor / QSU “Nënë Tereza”, me automjetet të posaçëm në pronësi/qira të Kontraktuesit, lehtësisht të identifikueshëm gjatë transportit të mbetjeve me shenjë dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjeve të rrezikshme spitalore në përputhje me pikat 8.8/c dhe shtojcën nr.4 të VKM-së Nr.798 dt.29.09.2010 dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar "Administrimi i sigurtë i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore".
3. Tërheqja e mbetjeve do të bëhet sipas nevojave dhe kërkesës së AK -së.

-
4. Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, apo nëpërmjet cdo mënyre poseidimi të njohur nga ligji, minimalisht 5 automjete llojit furgon, që nuk e kalojnë peshën totale me gjithë ngarkesë 3500 kg, pasi këto lloj automjete janë ë manovrueshëm për të qarkulluar në ambientet spitalore.
 5. Operatori ekonomik do të kryejë furnizimin me kontenier dhe qeset përkatëse të ambalazhimit sa herë që tërheq sasi të gjeneruara të mbetjeve dhe sa herë kërkohet nga Autoritetit Kontraktor. Materialet e furnizuara nga kontraktori duhet të jenë si më poshtë:
 - 5.1 Kontenierët plastikë ose kuti kartoni me qese plastmase duhet të jenë sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr.798 datë 29.09.2010 “Për Administrimin e mbetjeve spitalore” Pika 8/4 dhe 8/5 të Kreut III, Trajtimi i mbetjeve spitalore.
 - 5.1.1 Kutit plastikë njëpërdorimësh për të mprehtat 18 01 01, përmasa që fillon nga 3L, me ngjyrë të verdhë apo kombinim i të bardhës dhe të verdhës (në do vijohet me evadimin e këtyre mbetjeve).
 - 5.1.2 Kutit plastike të ripërdorshme me përmasa nga 30-60 L, për mbetjet infektive 18 01 03, të cilët për cdo përdorim duhet ti nënshtrohen pastrimit dhe larjes në makinerinë e posaçme të operatorit si dhe qese plastmase të verdhë.
 - 5.1.3 Kutit të kyçura farmaceutike/kontenierë të posaçëm ngjyrë e kuqe për mbetjet me kodin 18 01 08.
 6. Operatori Ekonomik nuk duhet të veprojë asnjëherë pa praninë e përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor. Për kryerjen e shërbimeve operatori ekonomik duhet të paraqesë situacionin përmbledhës, dokumentat dhe faturat shoqëruese për sa është realizuar, proces-verbalin për shërbimin e kryer të firmosur mes dy palëve (të operatorit ekonomik dhe përfaqësuesit të sektorit që monitoron kontratën), dokumentacion për depozitim të hirit, depozitim të mbetjeve të trajtuara, printime të impiantit të trajtimit dhe informacion mbi realizimin e asgjësimit/sterilizimit të mbetjeve .
 7. Operatori Ekonomik do të vejë në dispozicion peshore elektronike dore, me kapacitet maksimal mbajtës deri në 20 kg, për të pajisur pavionet e QSUNT si dhe peshore për çdo PAI, me kapacitet nga 100 kg deri në 150 kg. Peshoret për PAI-t me kapacitet nga 100 deri 150kg duhet të jenë të kolauduar nga Drejtoria e Metrologjisë.

Konkretisht duhet të vërë në dispozicion peshore si më poshtë:

 - 7.1 Peshore elektronike dore me kapacitet deri në 20 kg (70 copë).
 - 7.2 Peshore me kapaciteti nga 100 deri në 150 kg (7 copë).
- Shënim: Peshoret me kapacitet nga 100 kg deri në 150 kg për PAI-t, duhet të jenë të certifikuara CE dhe të kolauduara.
8. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve të grumbulluara, Operatori Ekonomik do të realizojë dezinfektimin e ambientit të grumbullimit të mbetjeve pranë AK, pas çdo evadimi mbetjesh.

-
9. Personeli i përfshirë në ngarkimin e koshave/ kontejnerëve tranzit duhet të jetë kompetent dhe i trajnuar siç duhet, detyrim që buron nga pika 9.3.2 e Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurtë të Mbetjeve. Sigurimi i jetës dhe shëndetit në punë të personelit është përgjegjësi e Kontraktorit.
10. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik tek një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike sipas shtojcës 1 të VKM-së Nr.371, datë 11.06.2014 për “Përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, i ndryshuar.
11. Për garantimin e standardeve të menaxhimit të cilësisë, mbi objektin e shërbimit, standardet mjedisore si dhe shëndetin dhe sigurinë në punë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë të gjitha Certifikatat si më poshtë :
- 11.1 ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent
- 11.2 ISO 14001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit) ose ekuivalent
- 11.3 ISO 45001:2018 (Mbi sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë) ose ekuivalent;
- Shënim: Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga RSH dhe brenda afatit të vlefshmërisë.
12. OE duhet të disponojë Akt-Miratim Higjeno-Sanitar të impiantit ky kryhet aktiviteti të lëshuar nga ISHSH, detyrim që buron nga pika 10.3, kreu IV, VKM Nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore".
13. **Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve me kodin 18.01.01, 18.01.03 dhe 18 01 08** duhet të realizohet me një prej metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara në VKM nr 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, konkretisht:
- 13.1 **Mbetjet me kodin 18 01 01 “ Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)” do të asgjësohen me sterilizim.**
- 13.2 **Mbetjet me kodin 18.01.03 “Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet” do të asgjësohen me sterilizim ose incenerim**
- 13.3 **Mbetjet me kodin 18 01 08* Medikamente citostatike dhe citotoksike” do të asgjësohen me incenerim.**
14. Operatori Ekonomik duhet të disponojë **Leje Mjedisore tipi A** (me kod III.1.C) **dhe B me** (kod III.1.B) **ose Leje Mjedisore tipi A** (me kod III.1.C) lëshuar nga Ministria e Mjedisit, së bashku me Akt Miratimin përkatës për asgjësimin e mbetjeve, ku të përfshij kodet e mbetjeve si më poshtë:

18 01 01 “Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)”

18 01 03 “Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet”

18 01 08 “Medikamente citostatike dhe citotoksike”

Licensën përkatëse të kategorisë **III.2.B.**

15. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, apo nëpërmjet cdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, implant/e, makineritë e mëposhtme që të mbulojnë trajtimin e mbetjeve 18 01 01, 18 01 03, 18 01 08 sipas Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”i ndryshuar si dhe të VKM-së për miratimin e rregullores “Për menaxhimin e mbetjeve spitalore” si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

15.1 Implant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalent) ose Implant për asgjësimin me incenerim si dhe ;

15.2 Implant për asgjësimin me incenerim si dhe ;

15.3 Makineri për larjen e kontenierëve (në rastet kur përdoren kontenier të ripërdorshëm)

16. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësim/trajtim, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që **del nga procesi i trajtimin me teknologjinë** iceneratorët ose piroliza e mbetjeve me kodin 19 01 ose produktin final që del nga procesi i trajtimin me teknologji me sterilizim, pra mbetje të stabilizuara të ngurtësuar me kodin 19 03.

Shpërndarja: 24 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a) Operatori duhet të ketë certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose **ekuivalent**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikata kerkohet te jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b) Operatori, duhet të ketë certifikatën ISO 45001-2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikata kerkohet te jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

c) Operatori, duhet të ketë certifikatën ISO 14001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikata kerkohet te jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

d) *Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve me kodin 18.01.01,18.01.03 dhe 18 01 08* duhet të realizohet nga impiante të miratuara nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit (ish Ministria e Mjedisit) për kryerjen e këtij shërbimi.

e) *Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve me kodin 18.01.01,18.01.03 dhe 18 01 08* duhet të realizohet me një prej metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara në VKM n.r798 datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, konkretisht:

18 01 01 “Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)” do të asgjësohen me sterilizim.

18 01 03 “Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet” do të asgjësohen me sterilizim ose incenerim.

18 01 08 “Medikamente citostatike dhe citotoksike” do të asgjësohen me incenerim.

f) Operatori Ekonomik duhet të disponojë **Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C) **dhe B me** (kod III.1.B) **ose Leje Mjedisore tipi A** (me kod III.1.C) lëshuar nga Ministria e Mjedisit, së bashku me Akt Miratimin përkatës për asgjësimin e mbetjeve, ku të përfshij kodet e mbetjeve si më poshtë:**

18 01 01 “Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)”

18 01 03 “Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet”

18 01 08 “Medikamente citostatike dhe citotoksike”

Licensën përkatëse të kategorisë **III.2.B** (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Nëse operatorët ekonomikë, që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe kontrata përkatëse, ose / dhe fatura tatimore të shërbimit, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shërbimit, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.

Nga OE të huaj ky kriter përmbushet me dokumentacion të lëshuar sipas legjislacionit të aplikueshëm në vendin e origjinës.

b) OE duhet të disponojë Akt-Miratim Higjieno-Sanitar të impiantit ky kryhet aktiviteti të lëshuar nga ISHSH, detyrim që buron nga pika 10.3, kreu IV, VKM Nr.798, datë 29.9.2010 "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore".

c) Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, apo nëpërmjet çdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/makineri që të mbulojë trajtimin e mbetjeve 18 01 01, 18 01 03, 18 01 08 sipas Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar si dhe të VKM-së për miratimin e rregullores "Për menaxhimin e mbetjeve spitalore" si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalent) ose Impiant për asgjësimin me incenerim si dhe ;
- b. Impiant për asgjësimin me incenerim si dhe ;
- c. Makineri për larjen e kontenierëve (në rastet kur përdoren kontenier të ripërdorshëm)

d) OE për të vërtetuar funksionalitetin e impiantit/makinerisë që do të përdoren, duhet të paraqesë Autodeklaratë ku të deklarojë se impianti/makineritë janë të pajisura me printer i cili regjistron dhe printon çdo detaj të procesit të punës (Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj.). Autodeklarata duhet të shoqërohet me disa printime

(minimalisht 2 ose 3 printime) të impantit/makinerisë, të paktën të 3 muajëve të fundit nga data e hapjes së procedurës.

- e) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë minimalisht 11 punonjës, ku të përfshijë:
- **Një Ekspert Mjedisor**, të certifikuar nga Institucioni Përkatës (MTM), i punësuar në këtë shoqëri të vërtetuar me Kontratë Pune, Çertifikatë (Eksperti Mjedisor), CV dhe të figurojë në paktën në muajin e fundit në listëpagesat e OE, i cili do të bëjë monitorimin e procesit, dhe parandalimin e problemeve të ndryshme që mund të vijnë.
- f) Operatori ekonomik duhet të të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësim/trajtim, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që **del nga procesi i trajtimit me teknologjinë** inceneratorët ose piroliza e mbetjeve me kodin 19 01 ose produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me sterilizim, pra mbetje të stabilizuara të ngurtësuar me kodin 19 03.
